



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, datë 14.10.2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Refuzimin e ankimit administrativ të paraqitur nga shoqëria “Sin-Tel” sh.p.k., dhe lënien në fuqi të vendimit për dënimin me gjobë nr. 41, datë 30.08.2024. (**Vendim nr. 102, datë 14.10.2024**)
2. Korrigjimin e datës së shtrirjes së efekteve të vendimit nr. 86, datë 12.10.2023, të AMA-s, për zëvendësimin e licencës të subjektit person fizik Emiljano Hoxhaj, për shërbimet e programit audioviziv “TV Glob”, me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor. Vendimi i shtrin efektet prej datës 12.10.2023. (**Vendim nr. 103, datë 14.10.2024**)
3. Refuzimin e ankimit administrativ të paraqitur nga shoqëria “Teknomedia” sh.p.k., dhe lënien në fuqi të vendimit për dënimin me gjobë nr. 43, datë 18.09.2024. (**Vendim nr. 104, datë 14.10.2024**)
4. Refuzimin e ankimit administrativ të paraqitur nga shoqëria “Media Vizion” sh.a., dhe lënien në fuqi të vendimit për dënimin me gjobë nr. 36, datë 28.08.2024. (**Vendim nr. 105, datë 14.10.2024**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 14 Tetor 2024